

REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA/GOVERNMENT OF KOSOVA  
ZYRA E KRYEMINISTRIT-KANCELARIA E PREMIERË-PRIME MINISTER OFFICE  
ARKIVI I KOSOVËS-ARHIVA KOSOVA-ARCHIVE OF KOSOVO

Nr./Br./No. 01/337/15  
Data/Datum/Date: 10.12.2015  
PRISHTINE-PRISTINA-PRISTINA



KOLEGJI - COLLEGE  
**BIZNESI**  
Prishtinë

KOLEGJI "BIZNESI"  
N. 378/15 10.12.2015  
PRISHTINE

Republika e Kosovës/Republika Kosova/ Republic of Kosovo  
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova /Government of Kosova  
Zyra e Kryeministrit / Ured Premijera /Office of the Prime Minister  
Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës

## MEMORANDUM BASHKEPUNIMI

NË MES TË:

AGJENCISË SHETETËRORE TË ARKIVAVE TË KOSOVËS

DHE

KOLEGJIT TE BIZNESIT NE PRISHTINE

Nisur nga synimi për themelimin dhe zhvillimin e bashkëpunimit në mes të dy institucioneve dhe në mbështetje të dispozitave pozitive ligjore (materijale e procedurale), Përfaqësuesit e autorizuar të subjektëve-pjesëmarrës në këtë Memorandum, përkatësisht Ramë Manaj, Kryeshef dhe Prof. Dr Shyqeri Kabashi , Dekan, pajtohen dhe me nënshkrimet e tyre të këtij Memorandumi vërtetojnë gadishmërinë reciproke të bashkëpunimit në kuptim të:

### Neni 1.

Këmbimit reciprok të botimeve të të dy institucioneve në kuadër të veprimtarive të tyre kulturo-arsimore e profesionale, me qëllim të pasurimit të fondeve dhe vënies së tyre në shërbim të përdoruesëve – goftë në formë fizike dhe /ose në linjë “on line”.

### Neni 2.

Palët këmbajnë publikimet me interes për institucionet që përfaqësojnë dhe marrin obligime reciproke që të ndihmojnë reciprokisht njëra-tjetrën në këtë fushë.

### Neni 3.

Palët ushtrojnë ndaj njëra-tjetrës të drejtën e përdorimit, shfrytëzimit dhe shkëmbimit të botimeve të tyre edhe në formë elektronike, CD-romëve, mikrofilmave dhe materialeve tjera të botuara nga të dy institucionet, me qëllim të ofrimit të këtyre botimeve shfrytëzuesëve, lexuesëve

apo hulumtuesëve e studijuesëve, sidomos të atyre botimeve që janë pjesë e memories kombëtare si dhe botimeve tjera me interes për palët.

#### Neni 4.

Palët këmbëjnë në mes vedi botimet e tyre beletristike, publicistike, shkencore e profesionale.

#### Neni 5.

Palët bashkëpunojnë në fushen e kërkimeve të ndërsjella dhe në përgaditjen e botimeve të përbashkëta, varësisht nga mundësitë dhe intereset e tyre.

#### Neni 6.

Palët bashkëpunojnë në promovimin e botimeve të autorëve ose të studijuesëve në fushat përkatëse.

#### Neni 7.

Palët nënshkruese të këtij Memorandumi mund të bashkëpunojnë edhe në organizimin e ekspozitave dhe veprimtarive të përbashkëta kulturore e shkencore me karakter kombëtar e ndërkombëtar.

#### Neni 8.

Palët bashkëpunojnë edhe në përurimin e trashëgimisë kulturore kombëtare, varësisht nga mundësitë e tyre si edhe perms rrjetit ndërkombëtar të informacionit.

#### Neni 9.

Ky Memorandum nuk ka kufizime kohore, mund të plotësohet e ndryshohet me pelqimin e palëve dhe mund të ndërpritet me lajmërim nga pala e caktuar, sëpaku një muaj paraprakisht.

#### Neni 10.

Memorandumi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit e përfaqësuesve të autorizuar të palëve.

Nënshkruar në Prishtinë, më 10 dhjetor 2015

Për ASHAK-në

Kryeshefi Ekzekutiv

Ramë Manaj



Për Kolegjin e Biznesit

Dekani

Dr. Shyqeri Kabashi

